



HILL CLIMB CHAMPIONSHIP
KRUJË, 29-30 GUSHT 2020

PLANI I MASAVE NDAJ COVID-19

Përmbajtja

1. Udhëzime
2. Mbërritja në event dhe kontrolli i njerëzve
3. Njohja me masat
4. Shenja dhe paralajmërime
5. Zyrtarët e garës
6. Masat në Parc Ferme
7. Marshallët
8. Media
9. Ceremonia e dorëzimit të trofeve

1.UDHËZIME

Auto Club Albania si organizatore e garës Hill Climb "Trofeu Skënderbej 2020" ka hartuar një plan masash ndaj Covid-19 përpara, gjatë dhe në përfundim të eventit që është parashikuar të zhvillohet në datat 29-30 Gusht 2020 në rrugën e Malit të Krujës në territorin e bashkisë Krujë. Në hartimin e këtij plani masash jemi mbështetur në udhëzimet dhe protokollat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si edhe në udhëzimet e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizmit (FIA) ku ACA është anëtare.

Me këtë plan masash synojmë që:

-Të ndihmojmë për të siguruar planifikimin dhe zhvillimin e këtij eventi sportiv në përputhje me praktikatat më të mira përkatëse dhe në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret kombëtare të shëndetit publik;

-Të japim udhëzime shëndetësore të nevojshme për aktorët kryesorë të eventit, zyrtarët dhe pjesëmarrësit;

-Të kemi një reagim të menjëhershëm për zbulimin, izolimin dhe menaxhimin e një apo më shumë personave që mund të shfaqin simptoma të Covid-19 gjatë eventit.

<https://new.shendetesia.gov.al/>

<https://www.fia.com/fia-return-motor-sport-guidelines>

2.MBËRRITJA NË EVENT DHE KONTROLLI I NJERËZVE

Auto Club Albania do të udhëzojë të gjithë pilotët dhe zyrtarët e garës që të ruajnë minimalisht një distancë prej 1.5 metrash nga njëri-tjetri. Nëpërmjet një termometri elektronik do të bëhet matja e temperaturës për të gjithë pjesëmarrësit në event.

Në rast të konstatimit të një apo më shumë personave me temperaturë mbi 37.5 gradë dhe shfaqje të simptomave të Covid-19, do të bëhet menjëherë izolimi dhe lajmërimi i autoriteteve shëndetësore.

3.NJOHJA ME MASAT

Grupi i punës i Auto Club Albania ka hartuar një strategji informimi për të gjithë ata që do të marrin pjesë në eventin "Trofeu Skënderbej 2020".



-Zyrtarëve të garës, pilotëve, marshallëve apo pjesëtareve të tjerë që janë pjesë e organizimit të këtij event, do të informohen me e-mail në lidhje me planin e masave Covid-19.

-Klubet do të informohen gjithashtu në lidhje me masat ndaj Covid-19.

-Dy javë përpara garës, Auto Club Albania do të informojë pjesëmarrësit në këtë event për masat ndaj Covid-19 nëpërmjet mjeteve të saj të komunikimit dhe në mediat sociale.

4.SHENJA DHE PARALAJMËRIME



5.ZYRTARËT E GARËS

Zyrtarët e garës do të jenë të pajisur me maska, doreza dhe dizifektant gjatë regjistrimit të pilotëve dhe takimeve të ndryshme përpara startit të eventit.

Gjithashtu, regjistrimi i pilotëve që do të marrin pjesë në këtë event do të bëhet në ambient të hapur në Malin e Krujës.

6.MASAT NË PARC FERME

Gjatë grumbullimit dhe kontrollit të automjeteve në Parc Ferme (zona e grumbullimit të mjeteve përpara dhe gjatë eventit), inxhinierët do të jenë të pajisur me maska, doreza dhe dizifektant.

-Gjatë kontrollit, do të jenë vetëm dy inxhinierë dhe piloti i makinës ku do të këshillohet që gjithmonë të ruhet distanca prej 1.5 metra minimalisht nga njëri-tjetri.



-Të gjithë pilotët do të informohen që gjatë të gjithë kohës së eventit të bëjnë kujdes për higjienën personale duke larë duart sa më shpesh, duke ruajtur distancën prej 1.5 metra nga njëri-tjetri dhe duke mbajtur maskë në ambientet e mbyllura.

7.MARSHALLËT

Marshallët do të qëndrojnë në pozicione në ambient të hapur gjatë mbajtjes së eventit dhe do të pajisen me doreza dhe dizifektant.

Marshallët qëndrojnë në distancë të konsiderueshme nga njëri-tjetri dhe nuk përbëjnë rrezik. Ata do të trajnohen dhe vendosen në dijeni në lidhje me masat ndaj Covid-19 në rast të një incidenti ku mund të duhet të mblidhen disa persona.

8.MEDIA

Kameramanët, gazetarët dhe fotografët që do të ndjekin nga afër këtë event, do të informohen tre javë përpara në lidhje me rregulloren e aktivitetit për sa i përket Covid-19.

Gjatë intervistave do të ruhet distanca e parashikuar prej 1.5 metrash, ndërsa përfaqësuesit e mediave do të jenë të pajisur edhe me maska dhe doreza.

9.CEREMONIA E DORËZIMIT TË TROFEVE

Sipas udhëzimeve të FIA-s, ceremonia e dorëzimit të trofeve do të zhvillohet pa pjesëmarrjen e publikut, për të evituar grumbullimin e madh të njerëzve.

Podiumet e pilotëve do të vendosen në një distancë prej 2 metrash nga njëri-tjetri. Personat që do të dorëzojnë kupat dhe pilotët do të jenë të pajisur me doreza, ndërsa do të këshillohet ruajtja e distancimit social prej 1.5 metrash.